

Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, shpall vendet e lira si më poshtë:

Qendra e gjuhëve të Huaja shpall 2 (dy) vende pune për personel akademik, kandidatët duhet të plotësojnë këto kriterë:

1. Të ketë përfunduar studimet universitare në degën Gjuhë Angleze (sistemi 4-vjeçar ose 3+2) Bachelor dhe Master i Shkencave në Gjuhën Angleze, pranë FGJH, Universiteti i Tiranës, ose në ndonjë universitet të huaj në degë analoge të ekuivalentuar nga MASR.
2. Të ketë notë mesatare mbi 8 (tetë), për studentët që kanë përfunduar studimet në Shqipëri, ose të ekuivalentuar mbi 8 (tetë) për studentët jashtë Shqipërisë.
3. Të ketë notë mesatare mbi 8.5 në lëndët e specialitetit, ose ekuivalentuar mbi 8.5 për studentët jashtë Shqipërisë.
4. Të ketë përvojë pune dhe praktika mësimdhënie në këtë gjuhë, si dhe njohuri dhe shprehje të mira përkthimi, interpretimi e studimi përmes teknologjisë në fushat teknike e inxhinierike.

Krahas konkurrimit me dosje aplikantët do t'i nënshtrohen intervistës në departament ku do të vlerësohet kultura e komunikimit si dhe njohuritë dhe shprehjet gjuhësore përmes kompetencës dhe performancës në gjuhë të huaj.

DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë duhet të paraqesin brenda datës **02.04.2021** pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Kopje e Diplomës Master i Nivelit të Dytë ose "DOKTOR" të noterizuar, në rast se ka. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.